



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.3, datë 08.02.2023

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR SHFRYTËZIMIN E MATERIALEVE  
INERTE OË NXIRREN NGASHTRATI I LUMIT MAT, SUBJEKTIT “G2  
INFRA” SH.P.K**

Në mbështetje të shkronjës të pikës 2 të nenit 50 , të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar , vendimit nr.550 datë, 15.07.2020 “*“Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”*”, sidhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Ujit me nr.1 prot., datë 7.7.2011, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Ujit nr.2 prot., datë 27.7.2012, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Mat,

V E N D O S I.

1. Miratimin e lejes për shfrytëzimin e materialeve inerte, subjektit “G2 Infra” sh.p.k. për zbatimin e Kontratës Koncesionare “Projektimin, Ndërtimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Aksit Rrugor Thumanë-Vorë Kashar”, me

vendndodhje, në shtratin e lumit Mat, Bashkia Kurbin, sipas këtyre koordinatave në sistemin KRRGJSH:

2. Treguesit paraprak të shfrytëzimit janë:

Zona e shfrytëzimit në sistemin KRRGJSH:

|              |               |                   |
|--------------|---------------|-------------------|
| X1 = 479913  | Y1 = 4618699  | Z1 = 20 m.m.n.d   |
| X2 = 479948  | Y2 = 4618676  | Z2 = 21 m.m.n.d   |
| X3 = 480013  | Y3 = 4618668  | Z3 = 23 m.m.n.d   |
| X4 = 480471  | Y4 = 4618688  | Z4 = 21 m.m.n.d   |
| X5 = 480624  | Y5 = 4618731  | Z5 = 22 m.m.n.d   |
| X6 = 480720  | Y6 = 4618471  | Z6 = 22 m.m.n.d   |
| X7 = 480413  | Y7 = 4618345  | Z7 = 19.4 m.m.n.d |
| X8 = 480086  | Y8 = 4618424  | Z8 = 20 m.m.n.d   |
| X9 = 480042  | Y9 = 4618500  | Z9 = 21 m.m.n.d   |
| X10 = 479917 | Y10 = 4618549 | Z10 = 20 m.m.n.d  |

3. Sasia e dhënë në përdorim për të gjithë periudhën e lejes është 240,000 m<sup>3</sup>;
4. Subjekti të respektojë të gjitha sygjërimet e dhëna nga AKM-ja dhe SHGJSH-ja;
5. Subjekti duhet të raportojë çdo muaj pranë ZABU Ishëm-Erzen-Mat për volumin e materialit të nxjerr nga shtrati;
6. Të ndiqet nga ZABU Ishëm-Erzen-Mat zbatimi i projektit të rehabilitimit;
7. Të mos depozitohet material stok në brigjet e shtratit pas përfundimit të kësaj leje;
8. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin ekëtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

**KRYETARI I KBU MAT**

**GJERGJ PRENDI**

